



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHETËRORE
PËR GJIMNAZIN**

LËNDA:

TRASHËGIMI KULTURORE

Koordinatore: Albana Markja

VITI MËSIMOR 2011 - 2012

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndën “Trashëgimi kulturore” përfshin njohuritë dhe konceptet më të rëndësishme të kësaj lënde për gjimnazin.

Programi orientues për provimin e lëndës “Trashëgimi kulturore”, në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2011-2012, përbën një dokument të vlefshëm për gjimnazet, për nxënësit e interesuar, për mësuesit dhe për specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimet e Maturës Shtetërore.

- Programi gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit e kësaj lënde, që do të përgatisin maturanët për provimin e trashëgimisë kulturore, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Programi, gjithashtu, orienton nxënësit për njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës “Trashëgimi kulturore”.
- Programi përbën një dokument zyrtar, që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të trashëgimisë kulturore, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program të shqyrtohet me kujdes dhe rigorozitet nga secili prej grupeve të interesuara, sidomos kujdes të bëhet nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të trashëgimisë kulturore, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim objektiva mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provimin e kësaj lënde të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t'i hartojë vetë, duke u bazuar në modelet e testeve të Maturës Shtetërore.

Testi për lëndën “Trashëgimi kulturore”, (i cili përfshin lëndën “Trashëgimi kulturore”, që zhvillohet në klasën e 10-të dhe 11-të) do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tria nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Peshat specifike për çdo nivel do të jenë:

Niveli bazë: 40%

Niveli mesatar: 40%

Niveli i lartë: 20%.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se linja, e cila ka numrin më të madh të orëve (objektivave) në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

Në përgatitjen për përmbushjen e objektivave të këtij programi do të përdoret teksti mësimor i kësaj lënde. Mund të përdoren edhe tekste ndihmëse apo materiale shtesë, që sigurojnë arritjen e objektivave të programit orientues.

PËRMBAJTJA E LISTUAR SIPAS OBJEKTIVAVE: TRASHËGIMIA JONË KULTURORE

Linja 1: TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE

Përshkrimi i linjës: Trashëgimia kulturore përfshin ndërtesat dhe vendet historike, monumentet, amforat etj. Këtu hyjnë objektet më domethënëse të arkeologjisë, arkitekturës, shkencës ose teknologjisë së kulturave të veçanta. Por, edhe trashëgimia natyrore është gjithashtu pjesë e rëndësishme e kulturës, ku përshihen flora dhe fauna, të njohura shkencërisht si biodiversitetet. Këto lloj trashëgimish shpesh shërbejnë si një komponent i rëndësishëm në industrinë e turizmit të një vendi, mjaft tërheqës për shumë vizitorë të huaj sa edhe për ata vendës.

Linja	Objektiva
Trashëgimia natyrore dhe kulturore	<p>Nxënës/-i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë trashëgiminë natyrore dhe kulturore si trashëgimi pa kufi; - të shpjegojë vendin që zë trashëgimia natyrore dhe kulturore në raport me fushat e tjera kurrikulare.

Linja 2: TRASHËGIMIA KULTURORE MATERIALE

Përshkrimi i linjës: Objektet janë të rëndësishme për studimin e historisë, sepse ato japin një bazë konkrete për idetë dhe mund t'i bëjnë të vlefshme ato. Në këtë linjë, nxënësit kuptojnë domosdoshmërinë e njohjes së të kaluarës nëpërmjet vendeve historike, mjedisve gjeografike, kalave, monumenteve, amforave etj. Njohja me veprat e artit dhe monumentet e natyrës është një pjesë e rëndësishme që brezat i përcjellin njëri-tjetrit si pasuri e pakufi dhe me vlera të mëdha identiteti njerëzor kombëtar dhe ndërkombëtar. Trashëgimia materiale është më e lehtë për t'u ruajtur dhe për t'u promovuar se sa trashëgimia shpirtërore, pasi qendrat historike dhe muzetë, veprat historike dhe artistike janë të mirëpërcaktuara fizikisht dhe të mbrojtura me ligje dhe rregulla të veçanta.

Linja	Objektiva
Trashëgimia materiale	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përkufizojë përmbajtjen e termit <i>trashëgimi kulturore materiale</i>; - të analizojë veçoritë e trashëgimisë kulturore materiale në raport me trashëgiminë kulturore shpirtërore;

	<ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë llojet e monumenteve të kulturës sipas vlerave të tyre: me vlera unikale, me vlera kombëtare dhe me vlera të veçanta; - të shquajë vlerat historike, artistike dhe shkencore të monumentit të kulturës; - të identifikojë kriteret e përfshirjes së monumenteve të kulturës në listës botërore të monumenteve të kulturës; - të identifikojë listën botërore të monumenteve të kulturës dhe shpërndarjen gjeografike të tyre; - të identifikojë monumentet të kulturës shqiptare në listën botërore të monumenteve të kulturës, si Parku Kombëtar i Butrintit - 1992, Qyteti - muze i Gjirokastrës dhe ai i Beratit; - të përshkruajë trashëgiminë kulturore materiale si trashëgimi pa kufi; - të shpjegojë konceptin e monumentit të kulturës si i luajtshëm dhe si i paluajtshëm; - të identifikojë shpërndarjen gjeografike të qendrave historike në vendin tonë; - të analizojë qendrat historike në vendin tonë si qendra të qytetërimit shqiptar; - të dallojë parqet kombëtare arkeologjike kryesore, si ai i Shkodrës, i Lezhës, i Apolonisë, i Bylisit, i Amantias, i Orikumit, i Antigonesë dhe i Finiqit; - të përshkruajë veçoritë kryesore të parqeve kombëtare arkeologjike; - të vlerësojë rëndësinë e parqeve kombëtare arkeologjike në kontekstin e zhvillimit dhe promovimit të turizmit kulturor; - të dallojë tipologjitë e monumenteve të kulturës së kultit, si kishat, xhamitë, teqetë; - të shpjegojë vlerat e tyre në pikëpamjen e arkitekturës, ndërtimit dhe vlerave artistike të tyre; - të përshkruajë veçoritë e kishave bizantine dhe postbizantine në Shqipëri, xhamive dhe teqeve, me statusin e monumentit të kulturës; - të përcaktojë listën dhe shpërndarjen gjeografike të tyre; - të dallojë llojet e ndërtimeve popullore; - të diferencojë disa nga ndërtimet popullore më të spikatura në vendin tonë; - të përshkruajë objektet etnografike si trashëgimi e luajtshme e trashëgimisë kulturore; - të dallojë larminë e objekteve etnografike në pikasjen e llojeve, të veçorive historike dhe të përbërjes; - të përshkruajë kostumet popullore si objekte
--	---

	<p>etnografike të trashëgimisë kulturore;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë veprat e artit si pjesë e trashëgimisë kulturore shqiptare; - të përshkruajë statusin e veprave të artit; - të identifikojë llojet e veprave të artit; - të dallojë veprat e artit në periudha të ndryshme historike të vendit tonë; - të evidentojë disa vepra të artit të njohura sipas personaliteteve të njohur të vendit dhe periudhave historike; - të identifikojë të gjitha institucionet e trashëgimisë kulturore materiale; - të përshkruajë restaurimin e monumenteve të kulturës; - të identifikojë Kartën Shqiptare të Restaurimit të Monumenteve; - të klasifikojë muzetë sipas mënyrës së organizimit: kombëtarë, vendorë, tipologjikë dhe privatë; - të përshkruajë artin e fotografisë si pjesë e trashëgimisë kulturore materiale; - të vlerësojë fotografinë si mjet për evidentimin e historisë dhe kulturës; - të identifikojë rrënjët e artit të fotografisë në vendin tonë; - të diferencojë dinastinë e fotografëve Marubi dhe fototekën “Marubi” në Shkodër; - të përshkruajë procesin e katalogimit të trashëgimisë kulturore, si informacioni, ruajtja dhe studimi; - të shpjegojë trafikimin e trashëgimisë kulturore.
--	--

Linja 3: TRASHËGIMIA KULTURORE SHPIRTËRORE

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë, nxënësit kuptojnë elementet e identitetit human, kombëtar dhe ndërkombëtar që lidhen me zhvillimin shoqëror të vendeve të ndryshme. Trashëgimia shpirtërore konsiston në aftësitë tradicionale, besimet, traditat, muzika, këngët, vallëzimi, drama etj. Të gjitha këto nuk mund të qëndrojnë në muzeum, por interpretohen dhe përcillen nga një brez në tjetrin dhe nga një rajon në tjetrin. Karakteristikat e vlerave historike, artistike dhe shkencore të kësaj trashëgimie trupëzohen në monumentet dhe kryeveprat e realizuara nga popujt dhe personalitetet e shquara të trashëgimisë kulturore në fushat e gjuhësisë, folklorit, artit pamor dhe muzikor, lojërave dhe valleve, ritualeve dhe festave etj.

Linja	Objektiva
Trashëgimia kulturore shpirtërore	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë përmbajtjen dhe strukturën e trashëgimisë shpirtërore; - të klasifikojë tipologjitë kryesore të trashëgimisë shpirtërore; - të përkufizojë karakterin e monumentit shpirtëror. - të klasifikojë llojet e trashëgimisë shpirtërore sipas fushave; - të tregojë vlerat historike, artistike dhe shkencore të kësaj trashëgimie; - të listojë monumentet e trashëgimisë shpirtërore në Republikën e Shqipërisë; - të tregojë kriteret e përfshirjes e kryeveprave në listën botërore; - të identifikojë ndërvarësinë midis trashëgimisë kulturore jo materiale dhe gjuhës; - të tregojë lidhjen e ndërsjellë midis traditave popullore dhe shprehjeve gojore; - të klasifikojë llojet e shprehjeve gojore; - të tregojë vendin e iso-polifonisë popullore shqiptare në listën botërore; - të klasifikojë llojet e iso-polifonisë; - të vlerësojë vendin e kësaj kryevepre në trashëgiminë botërore; - të klasifikojë llojet e folklorit muzikor, si elementet përbërës të trashëgimisë shpirtërore; - të përshkruajë folklorin vokal, folklorin muzikor instrumental dhe veglat muzikore popullore; - të klasifikojë llojet e vallëzimit popullor; - të tregojë karakteristikat e vallëzimit popullor; - të krahasojë dëshmitë arkeologjike dhe historike të folklorit koreografik; - të listojë disa nga dramat dhe spektaklet popullore; - të emërtojë zakonet tradicionale; - të përshkruajë ngjarjet festive dhe rituale të ndryshme; - të përshkruajë origjinën e ngjarjeve festive; - të tregojë se ç'është Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës; - të klasifikojë dhe të përshkruajë festivalet folklorike tipologjike kombëtare: Sazet - Korçë, Rapsodët - Lezhë, Iso-Polifonia - Vlorë, Vallëzimi popullor - Lushnjë dhe Kënga Qytetare - Elbasan; - të tregojë vlerat e tyre në ruajtjen e trashëgimisë

	<p>kulturore shpirtërore;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë rolin dhe funksionet kryesore të institucioneve që merren me trashëgiminë kulturore.
--	---

Linja 4: TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MJEDISI

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë, nxënësit kuptojnë vlerën e biodiversitetit (florës dhe faunës) dhe të monumenteve të natyrës të vendit dhe të botës. Ata njohin elementet që rrezikojnë vlerat e trashëgimisë natyrore dhe ndërgjegjësohen për t'i mbrojtur monumentet e natyrës nga zhdukja dhe dëmtimi.

Linja	Objektiva
Trashëgimia kulturore dhe mjedisi	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dallojë vendin që zë trashëgimia e veçantë natyrore në trashëgiminë e përgjithshme që ofron natyra e një vendi; - të rendisë kriteret e evidentimit të objekteve natyrore si trashëgimi e veçantë natyrore; - të përshkruajë ligjësitë e krijimit dhe evoluimit të trashëgimisë natyrore; - të dallojë kategoritë e trashëgimisë natyrore: botërore dhe kombëtare; - të identifikojë Listën e Trashëgimisë Botërore, me kriteret dhe rregullat e anëtarësimit të objekteve dhe site-ve të vendit në këtë listë; - të përkufizojë konceptin <i>trashëgimi natyrore kombëtare</i> dhe konceptin <i>zonë e mbrojtur</i>; - të rendisë kriteret e klasifikimit të zonave të mbrojtura sipas IUCN-së; - të identifikojë disa kategori të zonave të mbrojtura më karakteristike dhe më të rëndësishme të vendit tonë; - të listojë rreziqet natyrore dhe antropogjenë që kërcënojnë vlerat e trashëgimisë natyrore; - të përshkruajë rëndësinë e mjedisit si element kulturëbërës; - të vlerësojë mbrojtjen e tij; - të listojë disa nga monumentet e natyrës në Shqipëri dhe të përshkruajë veçoritë e tyre.

Linja 5: TRASHËGIMIA DHE TURIZMI KULTUROR

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë, nxënësit kuptojnë rëndësinë që ka trashëgimia natyrore dhe kulturore për zhvillimin turistik të një vendi ose të vendeve të ndryshme të botës. Monumentet e natyrës dhe të kulturës janë pjesë e identitetit të një kombi dhe faktorë të rëndësishëm të zhvillimit historik, ekonomik dhe social të tij. Nxënësit aftësohen për të vlerësuar turizmin si mjet të komunikimit ndërkulturor dhe për t'u bërë protagonistë të zhvillimit të tij në nivel vendor dhe kombëtar.

Linja	Objektiva
Trashëgimia kulturore dhe turizmi kulturor	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none">- Të përkufizojë se ç'është turizmi kulturor;- të përshkruajë lindjen dhe zhvillimin e turizmit kulturor;- të përshkruajë turizmin si mjet të komunikimit ndërkulturor;- të klasifikojë veçoritë dhe vlerat e marrëdhëniet mes trashëgimisë dhe turizmit kulturor;- të identifikojë problematikat në zhvillimin e këtij lloj turizmi dhe në ruajtjen e marrëdhënieve mes trashëgimisë dhe turizmit kulturor;- të përshkruajë veçoritë e turizmit kulturor në vendin tonë;- të përshkruajë veçoritë gastronomike në vendin tonë.- të listojë disa lloje gatimesh dhe pijesh me traditë vendase;- të përshkruajë disa prej artizanateve të ushtruara në vendin tonë;- të listojë disa lloje punimesh artizanale.

Linja 6: LEGJISLACIONI PËR TRASHËGIMINË NATYRORE DHE KULTURORE

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë, nxënësit kuptojnë se ruajtja e vlerave natyrore dhe kulturore bëhet nëpërmjet një legjislacioni të fuqishëm për zbatimin e të cilit është përfshirë dhe vendi ynë. Marrëveshjet dhe protokollet ndërkombëtare, ligjet e vendit dhe rregullat lokale janë pjesë e linjës së legjislacionit, ku një vend të rëndësishëm zë edhe njohja me organizatën botërore për edukimin, kulturën dhe shkencën UNESCO.

Linja	Objektivat
Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar për trashëgiminë natyrore dhe kulturore	Nxënës/-i,-ja duhet: <ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë Konventën Ndërkombëtare të Trashëgimisë Botërore, me përmbajtjen, strukturën dhe institucionet e saj; me detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga të qenit anëtar i kësaj konvente; - të përshkruajë legjislacionin shqiptar lidhur me trashëgiminë kulturore; - të identifikojë masat lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe popullarizimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.

PËRMBAJTJA E LISTUAR SIPAS OBJEKTIVAVE: TRASHËGIMIA EUROPIANE

Linja 1: TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE

Përshkrimi i linjës: Trashëgimia natyrore dhe kulturore europiane përbëhet nga vlera dhe site të veçanta, unike në shkallë kontinenti. Site të saj dallohen nga biodiversiteti i theksuar dhe peizazhi i veçantë, ku gjenden objekte të rralla gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike etj. Jo rrallë, në këto site të trashëgimisë natyrore takohen edhe vlera të veçanta kulturore.

Trashëgimia kulturore përfshin objektet më domethënëse të arkeologjisë, arkitekturës, shkencës ose teknologjisë së kulturave të veçanta.

Linja	Objektiva
Trashëgimia natyrore dhe kulturore	Nxënës/-i,-ja duhet: <ul style="list-style-type: none"> - Të zotërojë njohuri mbi Europën: kushtet e veçanta natyrore që mundësuan pasurinë e madhe të trashëgimisë natyrore të saj; popullimin e hershëm, veprimtarinë intensive jetësore dhe ekonomike të popullsisë në Europë në tërësi dhe rajonit të Europës Juglindore dhe Mesdhetare në veçanti, rolin e tyre në trashëgiminë shumë të pasur kulturore të këtij kontinenti; - të përshkruajë trashëgiminë kulturore europiane dhe identitetin europian; - të përshkruajë trashëgiminë natyrore dhe kulturore europiane (të luajtshme dhe të paluajtshme), si dhe veçoritë e saj si trashëgimi pa kufi.

Linja 2: TRASHËGIMIA KULTURORE MATERIALE

Përshkrimi i linjës: Objektet janë të rëndësishme për studimin e historisë, sepse ato japin një bazë konkrete për idetë dhe mund t'i bëjnë të vlefshme ato. Në këtë linjë, nxënësit kuptojnë domosdoshmërinë e njohjes së të kaluarës europiane nëpërmjet vendeve historike, mjediseve gjeografike, kalave, monumenteve, objekteve etj. Njohja me veprat e artit dhe monumentet e natyrës është një pjesë e rëndësishme që brezat i përcjellin njëri-tjetrit si pasuri e pakufishme dhe me vlera të mëdha identiteti njerëzor evropian dhe më gjerë. Trashëgimia materiale është më e lehtë për t'u ruajtur dhe për t'u promovuar se sa trashëgimia shpirtërore, pasi qendrat historike dhe muzetë, veprat historike dhe artistike janë të mirëpërcaktuara fizikisht dhe të mbrojtura me ligje dhe rregulla të veçanta.

Linja	Objektiva
<p>Trashëgimia Kulturore Materiale</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përkufizojë përmbajtjen e termit trashëgimi kulturore europiane materiale (e luajtshme dhe e paluajtshme); - të identifikojë tipologjitë kryesore të trashëgimisë kulturore materiale europiane; - të dallojë monumentet kulturore të antikitetit në hapësirën europiane, pjesë e “<i>Ëorld Heritage list</i>” UNESCO, si: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Rrënojat antike.</i> - <i>Qytetet antike.</i> - <i>Parqet arkeologjike.</i> - <i>Trashëgiminë arkeologjike nënujore dhe rëndësinë e saj.</i> - Të përshkruajë historikun e monumenteve europiane të kultit, pjesë e “<i>Ëorld Heritage list</i>”, UNESCO, si: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kishat.</i> - <i>Katedralet.</i> - <i>Manastiret dhe vendet e shenjta.</i> - Të përshkruajë vlerat arkitekturore të <i>disa qyteteve të vjetra dhe qendrave historike të Europës.</i> - Të dallojë dhe të përshkruajë fortifikimet, pjesë e “<i>Ëord Hertiage List</i>”, UNESCO, si: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kalatë.</i> - <i>Kështjellat.</i> - të analizojë këto monumente; - të identifikojë trashëgiminë kulturore materiale europiane të luajtshme; - të krahasojë vlerat dhe rëndësinë e saj;

	<ul style="list-style-type: none"> - për veprat e artit, - për objektet etnografike, - për kostumet dhe veglat muzikore; - të dallojë mjeshtrë europianë të fotografisë artistike; - të listojë disa nga institucionet europiane të trashëgimisë kulturore materiale, si: - Muzetë dhe arkivat. - Institucionet e restaurimit dhe mbrojtjes së monumenteve. - Institucionet e gërmimit arkeologjik. - Institucionet e katalogimit dhe digjitalizimit të trashëgimisë kulturore.
--	--

Linja 3: TRASHËGIMIA KULTURORE SHPIRTËRORE

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë, nxënësit kuptojnë elementet e identitetit human, europian dhe global që lidhen me zhvillimin shoqëror të vendeve të ndryshme. Trashëgimia shpirtërore konsiston në aftësitë tradicionale, besimet, traditat, muzikën, këngët, vallëzimi, drama etj. Të gjitha këto nuk mund të qëndrojnë në muze, por interpretohen dhe përcillen nga një brez në tjetrin dhe nga njëri rajon në tjetrin. Karakteristikat e vlerave historike, artistike dhe shkencore të kësaj trashëgimie trupëzohen në monumentet dhe kryeveprat e realizuara nga popujt dhe personalitetet e shquara të trashëgimisë kulturore në fushat e gjuhësisë, folklorit, artit pamor dhe muzikor, lojërave dhe valleve, ritualeve dhe festave etj. Linja u ofron nxënësve njohje dhe aftësim praktik me listën e shpallur të monumenteve shpirtërore europiane, ku përfshihen edhe ditët ndërkombëtare të trashëgimisë shpirtërore.

Linja	Objektiva
Trashëgimia Kulturore Shpirtërore	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë përmbajtjen dhe strukturën e trashëgimisë shpirtërore europiane; - të shpjegojë rëndësinë dhe veçoritë e kryeveprave të trashëgimisë shpirtërore; - të klasifikojë kryeveprat e trashëgimisë shpirtërore të njerëzimit në Europë; - të dallojë simbolet shpirtërore të Europës, si: - <i>Flamurin zyrtar të Europës,</i> - <i>Himnin zyrtar të Europës së Bashkuar,</i> - <i>Flamujt dhe himnet kombëtare;</i> - të përshkruajë folklorin vokal, folklorin muzikor instrumental dhe veglat muzikore popullore europiane; - të listojë 10 kryevepra muzikore popullore europiane; - të identifikojë disa zakone tradicionale europiane;

	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë ngjarje festive dhe rituale të ndryshme europiane; - të përshkruajë origjinën e tyre; - të dallojë disa kryevepra të spektaklit popullor; - të shpjegojë rrethanat historike dhe shoqërore të lindjes së spektaklit popullor; - të analizojë veçoritë e zhvillimit të teatrit tradicional europian në periudha të ndryshme historike; - të përshkruajë rolin dhe funksionet kryesore të institucioneve europiane që merren me trashëgiminë kulturore shpirtërore; - të përshkruajë domethënien e ditëve europiane, si: 9 Maji - <i>Dita e Europës</i>; - 20 Shtatori - Dita Kulturore e Europës; - 26 Shtatori - Dita Europiane e Gjuhëve, 24 Maji, Dita Europiane e Parqeve Natyrore.
--	---

Linja 4: TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MJEDISI

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë, nxënësit kuptojnë vlerat e rralla dhe unike të **siteve** të natyrës së Europës. Ata njohin elementet që rrezikojnë vlerat e trashëgimisë natyrore dhe ndërjegjësohen për t'i mbrojtur sitet e saj nga zhdukja dhe dëmtimi. Njohja e veprimeve konkrete, aksioneve dhe projekteve të ndryshme europiane i aftëson ata për të kapërcyer problemet e ndryshme që paraqet zhvillimi industrial dhe i formon me konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm. Njohja me institucionet dhe OJF europiane që mbrojnë site-t natyrore është një tjetër drejtim i rëndësishëm, që do të zhvillojë tek ata aftësitë e të konceptuarit të projekteve dhe zbatimit të tyre.

Linja	Objektiva
Trashëgimia kulturore dhe mjedisi	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dallojë sistemet e diferencimit të trashëgimisë natyrore në Europë: trashëgimia botërore dhe kombëtare; - të dallojë vendin që zë trashëgimia e veçantë natyrore europiane në trashëgiminë e përgjithshme botërore; - të përcaktojë kriteret e evidentimit të objekteve natyrore, si trashëgimi e veçantë natyrore; - të rendisë trashëgiminë natyrore europiane në “Eorld Heritage List”, UNESCO, si dhe kriteret e anëtarësimit të objekteve dhe site-ve europiane në këtë listë; - të identifikojë parqet dhe monumentet natyrore

	<p>europiane;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përkufizojë konceptin e trashëgimisë natyrore europiane dhe konceptin e zonës së mbrojtur; - të dallojë kriteret e klasifikimit të zonave të mbrojtura sipas IUCN-së; - të dallojë listën e qendrave të trashëgimisë natyrore europiane të rrezikuara; - të shpjegojë institucionet europiane dhe rolin e OJF-ve për ruajtjen e zonave të mbrojtura; - të listojë organizatat më të njohura europiane në fushën e mbrojtjes së mjedisit; - të dallojë rreziqet natyrore dhe antropogjenë që kërcënojnë vlerat e trashëgimisë natyrore europiane; - të përshkruajë rëndësinë e mjedisit natyror europian si element kulturëbërës; - të vlerësojë mbrojtjen e mjedisit natyror europian; - të identifikojë më shumë se 10 objekte nga lista e monumenteve të natyrës në Europë; - të përshkruajë karakteristikat dhe vlerat kryesore të site-ve europiane të trashëgimisë botërore: shtrirjen sipas rajoneve dhe shteteve.
--	--

Linja 5: TRASHËGIMIA DHE TURIZMI KULTUROR

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë, nxënësit kuptojnë rëndësinë që ka trashëgimia natyrore dhe kulturore për zhvillimin turistik të një vendi ose të vendeve të ndryshme europiane. Monumentet e natyrës dhe të kulturës janë pjesë e identitetit të një kombi ose kontinenti, si dhe faktorë të rëndësishëm të zhvillimit historik, ekonomik dhe social të tij. Nxënësit aftësohen për të vlerësuar turizmin si mjet të komunikimit ndërkulturor dhe për t'u bërë protagonistë të zhvillimit të tij në nivel vendor dhe kombëtar.

Linja	Objektivat
Trashëgimia dhe turizmi kulturor	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të analizojë se ç'përfaqëson turizmi kulturor europian në kontekstin botëror; - të identifikojë turizmin kulturor në Europë, duke shpjeguar dhe përshkruar <i>tipare të përgjithshme dhe veçoritë</i>; - të tregojë dhe të përshkruajë lindjen dhe zhvillimin e turizmit kulturor europian; - të përshkruajë turizmin si mjet të komunikimit ndërkulturor; - të identifikojë problematikat në zhvillimin e këtij lloj turizmi dhe në ruajtjen e marrëdhënieve mes

	<p>trashëgimisë dhe turizmit kulturor në Europë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë veçoritë gastronomike të vendeve europiane; - të listojë disa lloje gatimesh dhe pijesh me traditë europiane; - të përshkruajë disa prej artizanateve të ushtruara në Europë.
--	---

Linja 6: LEGJISLACIONI PËR TRASHËGIMINË NATYRORE DHE KULTURORE

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë, nxënësit kuptojnë se ruajtja e vlerave natyrore dhe kulturore europiane realizohet nëpërmjet një legjislacioni të fuqishëm për zbatimin e të cilit është përfshirë dhe vendi ynë. Marrëveshjet dhe protokollet ndërkombëtare, ligjet e vendit dhe rregullat lokale (vendore) janë pjesë e linjës së legjislacionit, ku një vend të rëndësishëm zë edhe njohja me organizatën botërore për edukimin, kulturën dhe shkencën UNESCO.

Linja	Objektiva
<p>Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar për trashëgiminë natyrore dhe kulturore</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë Konventën Ndërkombëtare për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore të Parisit; - të tregojë për konventat e UNESCO-s për trashëgiminë kulturore dhe rëndësinë e tyre: - Konventa e UNESCO-s “Për diversitetin kulturor”, 21 Maji - Dita botërore e diversitetit kulturor, - Konventa e UNESCO-s “Për luftën kundër trafikimit të veprave të artit dhe trashëgimisë kulturore”, - Konventa e UNESCO-s “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike nënujore”; - të përshkruajë statusin ligjor të mbrojtjes së monumenteve të natyrës dhe kulturës: modelet më të mira në disa shteteve europiane.

SHPËRNDARJA E PESHAVE SIPAS FUSHAVE

1.	Trashëgimia jonë kulturore	47 orë	56%
2.	Trashëgimia europiane	40 orë	44%

SHPËRNDARJA E PESHAVE SIPAS LINJAVE

Trashëgimia jonë kulturore

Nr.	Linja	Ndarja e peshave në orë mësimore	Ndarja e peshave në përqindje
1.	<i>Trashëgimia natyrore dhe kulturore</i>	2	5%
2.	<i>Trashëgimia kulturore materiale</i>	15	31%
3.	<i>Trashëgimia kulturore shpirtërore</i>	10	21%
4.	<i>Trashëgimia kulturore dhe mjedisi</i>	9	19%
5.	<i>Trashëgimia kulturore dhe turizmi</i>	9	19%
6.	<i>Legjislacioni për trashëgiminë natyrore dhe kulturore</i>	2	5%
	Totali:	47	100%

Trashëgimia europiane

Nr.	Linja	Ndarja e peshave në orë mësimore	Ndarja e peshave në përqindje
1.	<i>Trashëgimia natyrore dhe kulturore</i>	2	5%
2.	<i>Trashëgimia kulturore materiale</i>	13	33%
3.	<i>Trashëgimia kulturore shpirtërore</i>	10	25%
4.	<i>Trashëgimia kulturore dhe mjedisi</i>	7	17%
5.	<i>Trashëgimia kulturore dhe turizmi</i>	6	15%
6.	<i>Legjislacioni për trashëgiminë natyrore dhe kulturore</i>	2	5%
	Totali:	40	100%